

## **Albania**

### **Grupet e fizkulturës aplikative për fëmijë dhe të rinj**

#### **Në javët 36-49 dhe 2-18**

Grupet janë të parapara për fëmijë dhe të rinj të cilët kanë nevojë për mbështetje të posaçme në fizkulturë, të cilët kërkojnë një hobi komod për vete. Për çdo javë ofrohen grupe të shumta të ndryshme të fizkulturës, në të cilat mund të përjetohen lumturia dhe gëzimi nga fizkultura. Eja bashkë me ne të kërcejmë, të vallëzojmë, të lozim dhe të notojmë!

Të dhëna shtesë: [turku.fi/soveltavaliikunta](http://turku.fi/soveltavaliikunta) -> lasten soveltavan liikunnan ryhmit kausiesite.

#### **Ushtro hobin tënd gjatë kohës në shkollë**

Shkathtësi themelore të fizkulturës dhe ushtrime të shumëllojshme brenda dhe jashtë!  
Aktivitete të lira pa pagesë organizohen gjatë ditëve të shkollës në javët 36-49 dhe 2-18 (jo gjatë javëve të pushimeve shkollore). Pyesni rreth hobive / aktiviteteve të lira, përgjegjës in e klubit ose mësuesin e fëmijës tuaj.

Hobit që mund të ushtrohen në shkolla të caktuara gjenden të grumbulluara në:

[turku.fi/harrastelukkarit](http://turku.fi/harrastelukkarit)

#### **Aktivitetet KouluPT dhe KouluPCAC**

Aktiviteti „Koulu Personale Trainer“ (KouluPT) përmban udhëzime të fizkulturës dhe mirëqenies për nxënësit klasave të epërme të shkollave fillore, ku inkurajojmë të rinjtë për të shtuar aktivitetin e tyre të përditshëm duke mbështetur fusha të ndryshme të mirëqenies.

Aktiviteti „Koulu Personal Culture & Arts Coach“ (KouluPCAC) përmban udhëzime të artit dhe kulturës për nxënësit e klasave të epërme të shkollës fillore, ku synojmë të shtojmë mirëqenien kulturore si dhe ndihmojmë të rinjtë për t'u afruar me artin dhe kulturën.

Të dhëna shtesë rreth shkollave pjesëmarrëse në këto aktivitete:

[turku.fi/harrastamisen-turun-malli](http://turku.fi/harrastamisen-turun-malli)

#### **MIHI**

##### **Në javët 36-49 dhe 2-18 (jo në javën 8).**

MIHI ofron mbi 40 radhë të disiplinave të ndryshme të fizkulturës pa pagesë në Turku për të rinjtë 12-19 vjeçarë. Ka mundësi të shumëllojshme të disiplinave individuale si dhe ekipore. Përpos atyre disiplinave mund të shkoni privatisht edhe për të rrëshqitur në qilimin e rrëshqitjes dhe për të vrapuar me ski në Impivaara (pajisjet pa pagesë). Të rinjtë kanë mundësi gjithashtu që të rezervojnë terminë për të lozur në salla të shkollave të Turkut. Në terminët MIHI nuk ka nevojë të lajmërohesh paraprakisht (përpos për bilardo dhe për lojërat me laser).

Të dhëna shtesë: [jorma.fisk@turku.fi](mailto:jorma.fisk@turku.fi) ose tel. 050 554 6250

Shihni: [mihi.fi](http://mihi.fi)

#### **Aktiviteti kërkimor për hobi në shkolla**

Në shumë shkolla fillore të Turkut organizohen aktivitete për të kërkuar hobi. Ky shërbim është i paraparë për nxënësit e shkollave pjesëmarrëse, të cilët akoma nuk kanë gjetur për vete ndonjë aktivitet të lirë që u pëlqen. Koordinator i aktivitetit kërkimor për hobi i shkollës tuaj ndihmon dhe këshillon nxënësit për të gjetur hobin që u pëlqen atyre.

Të dhëna shtesë: [turku.fi/koulujen-etsiva-harrastustoiminta](http://turku.fi/koulujen-etsiva-harrastustoiminta)